

**SHPËRNGULJA E SHQIPËTARVE TË KOSOVËS NË TURQI
NË VITETEE 50-TA**

**TEMA PER TITULLIN
MASTER I SHKENCËS SË HISTORISË**

**NGA
LUMNIJE HASANI**



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS HASAN PRISHTINA
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PRISHTINË**

JANAR ,2021

EKSPOZE E TEMESË

SHPËRGULJA E SHQIPËTARVE TË KOSOVËS NË TURQI NË VITETEE 50-TA

Mentor:

Prof. Dr. Ibrahim Gashi

Kandidatja:

Lumnije Hasani

Qellimi bazë i këtij hulumtimi është analizimi i situatës mbi shpërnguljen e shqipëtarve të Kosovës për në Turqi kryesisht në vitet e 50-ta. Në kuadër të këtij hulumtimi analizohen shkaqet dhe faktorët kryesor që shtynë në shpërnguljen masive të shqipëtarve të Kosovës në Turqi. Ndër të tjerash ky punim synon të paraqes rrethanat sociale të shpërnguljeve dhe sfidat që popullulli i Kosovesë përjetojë nga udhëheqja e asaj kohe. Metodologjia e hulumtimit e përdorur në këtë punim përbëhet nga metoda të kombinuara nga përshtures, statistikore dhe përdorimi i të dhënave kryesisht sekondare. Për përgatitjen e punimit do të mblidhen të dhëna përmes përdorimit të literaturës shkencore dhe profesionale nga autorë të ndryshëm, si dhe përdorimit të botimeve nga ekspertë, revistave shkencore në fushën e historisë dhe shkencave sociale.

Literatura e referuese për realizimin e këtij hulumtimi përbëhet kryesisht nga publikime zyrtare në internet. Ndër të tjerash kamë shfrytëzuar edhe arkivat me statistika të cilat përmbajnë informacion lidhur me numrin e të shpërngulurve për në Turqi në vitet 50-ta.

Punim është ndarë në dy kapituj. Në pjesën e parë të hulumtimit u diskutua kryesisht për shpërnguljen e shqiptarëve gjatë dhe pas luftërave ballkanike 1912 duke vazhduar tutje tek politika e konvertimit të dhunshëm fetar si mjet spastrimi etnik. Pjesa e dyte e këtij kapitulli lidhur me shpërnguljet e shqiptarëve deri në vitin dhe për shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi. Në këtë pjesë të punimit u diskutua edhe për konventen jugosllave-turke për shpërnguljen e shqiptarëve në vitin 1938. Kjo pjesë e punimit perfundoi duke diskutuar për shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi 1937-1941 dhe roli i Bashkësisë Fetare Islame në pengimin e saj. Në pjesën e dytë të punimit u diskutua në terminologji të përgjithësuar në lidhje me ringjalljen e projektit serb për shpërnguljen e shqiptarëve duke vazhduar tutje me politikën e dhunës dhe presionit për shpërngulje

të Shqipëtarëve gjatë viteve të 50. Kapitulli vazhdon tutje duke jap informacion ne lidhje me marrëveshjen turko-jugosllave e vitit 1953. Pjesa e fundit e ketij kapitulli flet per përmasat e shpernguljve së shqipëtarëve në Turqi gjatë viteve të 50-ta 57 si dhe ne lidhje me qëndrimin e Qeverisë Shqipëtarë ndaj shpërnguljes së shqiptarëve të Kosovës për në Turqi.